

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHITJA LASKA DHE LIKA kundër SHQIPËRISË

(Aplikime nr. 12315/04 dhe 17605/04)

GJYKIM

STRASBURG

20 prill 2010

Ky gjykim do të marrë formë përfundimtare në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaksional.

Në çështjen Laska dhe Lika kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e Të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e ngritur si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, *President*,
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić, *gjyqtarë*,
dhe Fatoş Aracı, *Zëvendës Regjistruer i Seksionit*,

Pasi gjykoi privatisht më 12 janar 2010 dhe më 23 mars 2010,

Jep gjykimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën më të fundit të përmendur:

PROCEDURË

1. Çështja e pati fillimin me dy aplikime (nr. 12315/04 dhe 17605/04) kundër Republikës së Shqipërisë regjistruar në Gjykatë sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga dy nënshtetas shqiptarë, Z. Vladimir Laska dhe Z. Artur Lika (“aplikantët”), më 8 mars 2004.
2. Aplikantët u përfaqësuan nga Z. A. Dobrushki i Qendrës Europiane për Të Drejtat e Romëve dhe më pas u bashkëpërfaqësuan nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Qeveria Shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjenti i saj i atëhershëm Znj. S. Meneri dhe, pas paraqitjes së komenteve të tyre mbi pretendimin e aplikantëve për zgjidhje të drejtë, nga Agjenti i saj Znj. E. Hajro.
3. Aplikantët u ankuan sipas Nenit 3 të Konventës se i ishin nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga policia me qëllim që të detyroheshin të pranonin kundravajtjet e pretenduara. Ata u bazuan edhe mbi Nenin 6 § 1 të Konventës për t’u ankuar mbi padrejtësinë e procedimeve.
4. Më 10 tetor 2007, Zv.Presidenti i Seksionit, të cilit iu caktua çështja, vendosi t’ia komunikonte aplikimin Qeverisë. Sipas dispozitave të Nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtoheshin cilësitë e aplikimeve në të njëjtën kohë si dhe pranueshmëria e tyre.
5. Aplikantët dhe Qeveria paraqitën secili vëzhgime të mëtejshme me shkrim (Rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Aplikantët të dy janë lindur në vitin 1980 dhe aktualisht vuajnë dënime me burgim në Burgun e Burrelit, Shqipëri.

A. Arrestimi i aplikantëve

7. Më 31 mars 2001, në agim, tre persona me kapuçë blu dhe të bardhë grabitën një furgon në linjën midis Tiranës dhe Kukësit. Agresorët ishin të armatosur me dy kallashnikovë dhe një thikë. Pasi kishin marrë paratë dhe bizhuteritë e pasagjerëve, ata ishin larguar pa shkaktuar viktima.

8. Disa orë pas ngjarjes, policia kontrolloi shtëpitë pranë skenës së krimit, përfshi atë të Z. Lika (“aplikanti i dytë”), ku ai ishte duke ngrënë drekë me të atin e tij, vëllain e tij, B.L., dhe mikun e tij Z. Laska (“aplikanti i parë”).

9. Oficerët e policisë e kryen kontrollin e përmendur pa praninë e avokatit të aplikantëve.

10. Sipas raportit të policisë për kontrollin, policia gjeti në xhepin e xhakëtës së aplikantit të parë dy bluza të bardha dhe një copë blu, të shndërruara në kapuçë. Për më tepër, pranë shtëpisë, ata gjetën edhe disa granata, por nuk arritën të gjenin sendet e vjedhura apo armët që kishin pasur agresorët.

11. Aplikantët, B.L., dhe babai u shoqëruan në stacionin e policisë për t’u marrë në pyetje. Aplikanti i parë kërkoi, por u refuzua, praninë e avokatit të tij (H.B). Ai kundërshtoi të kishte pasur një kapuç apo ndonjë lloj tjetër maske dhe e akuzoi policinë për manipulim të provave.

12. Të njëjtën ditë, oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin vazhduan me identifikimin e personave dhe sendeve nga vikimat e grabitjes, sipas Neneve 171 dhe 172 të Kodit të Procedurës Penale (“KPP”). Avokati i aplikantëve nuk ishte i pranishëm.

13. Në lidhje me identifikimin e personave, aplikantët dhe B.L., veshur me kapuç blu dhe të bardhë të bërë vetë, dhe dy persona të tjerë, veshur me kapuçë të zinj, ishin vendosur në radhë në të njëjtën dhomë me qëllim që të identifikoheshin. Përveç faktit që policia kishte ndërruar pozicionin e personave në dhomë, viktimat në mënyrë të përsëritur i identifikuan personat me kapuçë blu dhe të bardhë si agresorët, pra aplikantët dhe B.L.

14. Në lidhje me identifikimin e sendeve, viktimave iu kërkua të identifikonin kapuçët e përdorur nga agresorët, duke zgjedhur me kapuçëve të zinj, dy kapuçëve të bardhë dhe një kapuçi blu. Viktimat identifikuan kapuçët e bardhë dhe blu si ato që kishin veshur agresorët.

15. Në orën 9.30 të mbrëmjes në të njëjtën ditë, aplikantët dhe B.L. u arrestuan nën dyshimin e grabitjes me armë. Ata u morën në pyetje nga policia pa praninë e një avokati, pavarësisht nga fakti që B.L. ishte minoren në atë kohë dhe që aplikantët kishin kërkuar shprehimisht praninë e një avokati. Aplikanti i parë pranoi që zotëronte një bluzë të bardhë, shndërruar nga F.N, një oficer policie ngarkuar me hetimet, në një kapuç të bërë vetë. Aplikanti i dytë deklaroi që bluza e bardhë që ishte gjetur në zotërim të aplikantit të parë nuk ishte e tij.

16. Më 2 prill 2001, aplikantët dhe B.L. u akuzuan për grabitje me armë dhe për zotërim të paligjshëm armësh. Në të njëjtën ditë, ata u morën në pyetje nga prokurori. Aplikanti i parë kërkoi të përfaqësohej nga H.B. Aplikanti i dytë kërkoi t'i caktohej një avokat.

B. Procedimet penale kundër aplikantëve

17. Më 29 qershor 2001, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm (ZPP) kërkoi të inspektonte dosjen e hetimit penal të aplikantit të dytë. Më 10 shtator 2001, ZPP dha pëlqimin për çuarjen e çështjes në gjyq.

18. Më 11 shtator 2001, prokurori i çoi aplikantët dhe B.L. në gjyq me akuzat e grabitjes me armë dhe zotërimit të jashtëligjshëm të armëve.

19. Gjatë seancës së 26 nëntorit 2001 përpara Gjykatës së Rrethit të Pukës (“Gjykata e Rrethit”), aplikantët kundërshtuan akuzat kundër tyre dhe i kërkuan gjykatës së rrethit që të deklaronte të pavlefshëm identifikimin e kryer nga policia të personave dhe sendeve, sepse kishte qenë kryer duke shkelur dispozitat përkatëse të KPP. Për më tepër, ata akuzuan oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin për manipulim të fakteve kundër tyre: aplikantët për rrjedhojë i kërkuan gjykatës që të thirreshin policët si dëshmitarë dhe të paraqisnin në gjyq sendet që policia i kishte konsideruar kapuçë, por që, në pikëpamjen e tyre, ishin veçse bluza. Në lidhje me akuzën për zotërim të jashtëligjshëm të armëve, aplikantët këmbëngulën që hetimi nuk kishte arritur të gjente armët e përdorura nga kundravajtësit gjatë grabitjes dhe nuk ishte provuar që granatat e gjetura të kishin qenë në zotërim të tyre. Të dy aplikantët u përfaqësuan nga i njëjti avokat, P.Gj.

20. Më 24 maj 2002, Gjykata e Rrethit e hodhi poshtë kërkesën e aplikantëve për thirrur oficerët e policisë si dëshmitarë, pa dhënë arsye. Megjithë faktin që gjykata vërejti parregullsi të caktuara gjatë fazës së hetimit (të tilla si mungesa e një avokati gjatë marrjes në pyetje të aplikantëve dhe gjatë identifikimit të personave dhe sendeve), gjykata i gjeti aplikantët fajtorë për grabitje me armë mbi bazën e identifikimit nga dëshmitarët okularë të aplikantëve si kundravajtësit. Për më tepër, gjykata i gjeti aplikantët fajtorë për zotërim të jashtëligjshëm të dy kallashnikovëve dhe B.L. fajtor për zotërimin e një thike. Duke qenë se nuk ishin gjetur armë, dënimi i aplikantëve ishte bazuar mbi deklaratimet e dëshmitarëve okularë. Gjykata i dënoi aplikantët me trembëdhjetë vjet burgim dhe B.L. me pesë vjet burgim. Aplikantët u urdhëruan të kryenin dënimin në një burg të sigurisë së lartë.

21. Më 29 maj 2002, aplikantët apeluan në Gjykatën e Apelit të Shkodrës (“Gjykata e Apelit”), për arsye se gjykimi i Gjykatës së Rrethit ishte përfundim i procedimeve të padrejta. Ata argumentuan që identifikimi kishte qenë kryer në shkelje flagrante të Neneve 171-175 të KPP sepse u ishin veshur të njëjtët kapuçë gjatë paradës së identifikimit. Kërkesa e avokatëve të tyre për pavlefshmëri të akteve lidhur me identifikimin ishte refuzuar nga gjykata. Ata pohuan gjithashtu që asnjë prej fakteve material (kapuçët), siç ishte kërkuar prej tyre, nuk ishte paraqitur në seancat gjyqësore. Për më tepër, autoritetet nuk arritën të gjenin paratë dhe armët që ishin përdorur në grabitje.

22. Më 9 shtator 2002, Gjykata e Apelit la në fuqi gjykimin e Gjykatës së Rrethit.

23. Më 7 tetor 2002, aplikantët apeluan në Gjykatën e Lartë. Ata u mbështetën mbi të njëjtat arsye apeli si edhe përpara Gjykatës së Apelit. Ata pretenduan gjithashtu se që të dy kishin qenë përfaqësuar nga i njëjti avokat përpara gjykatave më të ulëta, në një kohë kur kishte mospërputhje në dëshmitë e tyre të dhëna gjatë hetimit penal.

24. Më 26 dhjetor 2002, Gjykata e Lartë e deklaroi apelin të papranueshëm sepse baza e tij binte jashtë sferës së Nenit 432 të KPP.

25. Në një datë të paspecifikuar, aplikanti i parë paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese mbi padrejtësinë e procedimeve. Ai u bazua mbi të njëjtat arsyetime si ato që u ngritën përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

26. Më 17 shtator 2004, Gjykata Kushtetuese, në një panel prej tre gjyqtarësh, e deklaroi ankesën të papranueshme. Ajo arsyetoi se ankesat e aplikantit nuk ngrinin çështje të një gjyqi të drejtë, por kishin kryesisht të bënin me vlerësimin e fakteve, çka është funksion i gjykatave më të ulëta.

C. Pretendim për keqtrajtim gjatë qëndrimit në polici

27. Aplikantët pretenduan se kishin qenë keqtrajtuar nga F.N. dhe oficerë të tjerë policie gjatë marrjes në pyetje nga policia. Ata pretenduan që ishin lidhur me litarë, rrahur dhe u ishte hedhur ujë i ftohtë gjatë marrjes në pyetje.

28. Në seancat e 26 nëntorit 2001 përpara Gjykatës së Rrethit, aplikantët pretenduan se kishin qenë keqtrajtuar nga oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin, sepse këta ishin përpjekur t’i detyronin të pranonin grabitjen dhe të tregonin vendndodhjen e sendeve dhe armëve të përdorura. B.L. dhe aplikantët dhanë të njëjtin përshkrim për keqtrajtimin e pretenduar.

29. Më 24 maj 2002, Gjykata e Rrethit refuzoi kërkesat e aplikantëve me arsyetimin se ishin paraqitur përtej kufirit kohor prej gjashtë muajsh. Në gjykim nuk ishte përmendur ndonjë bazë ligjore.

II. E DREJTA DHE PRAKTIKA PËRKATËSE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

A. E drejta dhe praktika përkatëse kombëtare

1. Kodi i Procedurës Penale

30. Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë (“KPP”) në pjesët e veta përkatëse lexon si më poshtë:

Neni 171: Njohja e personave

1. Kur lind nevoja për të proceduar në njohjen e një personi, organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.

2. Në procesverbal shënohen veprimet e parashikuara nga paragrafi 1 dhe deklaratimet e bëra nga personi që bën njohjen.

3. Mosrespektimi i dispozitave të parashikuara nga paragrafët 1 dhe 2 është shkak për pavlefshmërinë e njohjes

Neni 172: Kryerja e njohjes

1. Pasi largon atë që duhet të bëjë njohjen, organi procedues siguron praninë e të paktën dy personave sa më të ngjashëm me atë që duhet të njihet. E fton këtë të fundit të zgjedhë vendin e tij në raport me të tjerët duke u kujdesur që të paraqitet, sa të jetë e mundur, në të njëjtat kushte në të cilat do të kishte qenë parë nga personi i thirrur për njohje. Pasi paraqitet personi që do të bëjë njohjen gjykata e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.

2. Kur ka arsye të mendohet se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të frikësohet ose të ketë ndikime të tjera nga prania e personit që duhet njohur, organi procedues urdhëron që veprimi të kryhet pa e parë ky i fundit të parin.

3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes. Organi procedues mund të urdhërojë që zhvillimi i njohjes të dokumentohet edhe me fotografime ose filmime.

Neni 173: Njohja e sendeve

1. Kur duhet proceduar në njohjen e provave materiale ose të sendeve të tjera që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen.

2. Pasi gjenden, kur është e mundur, të paktën dy objekte të ngjashme me atë që duhet

njohur, organi procedues e pyet personin e thirrur për njohje nëse njeh ndonjërin prej tyre dhe, në rast se po, e fton të deklarojë se cilin ka njohur dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.

3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes.

Neni 175: Njohja nga disa persona ose e disa personave

1. Kur disa persona thirren për të bërë njohjen e të njëjtit person ose të të njëjtit objekt, organi procedues kryen veprime veç e veç duke ndaluar çdo komunikim ndërmjet atij që ka kryer njohjen dhe atyre që duhet ta bëjnë atë më pas.

2. Kur një person duhet të bëjë njohjen e disa personave ose të disa objekteve, organi procedues urdhëron, që personi ose objekti që duhet njohur të futen ndërmjet personave ose objekteve të ndryshme.

3. Aplikohen dispozitat e Neneve 171, 172 dhe 173 të KPP.

Neni 205: Kontrolli i vendit

1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke i sqaruar të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar.

2. Kur mungojnë personat e treguar në paragrafin 1, kopja e vendimit i dorëzohet një të afërmi, një fqinji ose një personi që punon bashkë me të.

3. Organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin provën materiale ose sendet që i përkasin veprës penale. Ai mund të urdhërojë që të pranishmit të mos largohen para se të mbarojë kontrolli dhe të kthehen forcërisht ata që largohen.

Neni 256: Marrja në pyetje e të arrestuarit ose të ndaluarit

Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarit faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet.

Neni 380: Provat e përdorura nga gjykata

Për të marrë vendimin, gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.

31. Nenet 449–461 të KPP rregullojnë aplikimin për rishikim të një vendimi të formës së prerë. Sipas Neni 451, i dënuari ose prokurori mund të paraqesin kërkesë për rishikim në

përputhje me bazat e kufizuara për rishikim që gjenden në Nenin 450. Kërkesa i paraqitet Gjykatës së Lartë, e cila mund të vendosë ta refuzojë ose ta pranojë atë (Neni 453).

Gjykim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6, 11 tetor 2002

32. Në përpyetje për të harmonizuar praktikën ligjore, Kolegjet e Bashkuara shqyrtuan institucionit të rishikimit gjyqësor në gjykimin e tyre nr. 6 të 11 tetorit 2002. Pjesët përkatëse të gjyimit lexonin:

“(…) Pranohet që rishikimi i vendimeve të formës së prerë është një masë e jashtëzakonshme, e vetmja, e parashikuar nga ligjvënësi në KPP me qëllim zhbërjen e ndonjë gabimi gjyqësor (në respekt të gjykimeve përfundimtare të gjykatave).

Gjyqi që zhvillohet, si rezultat i rishikimit [procedimi], nuk kufizohet thjesht në një rishikim (në kuptimin më të ngushtë të fjalës) të gjyqit të mëparshëm. Në përfundim të tij, gjykata, pasi ka shqyrtuar faktet, rrethanat dhe të dhënat e paraqitura nga palët, të marra sëbashku dhe në përputhje me të dhënat, rrethanat dhe faktet e administruara dhe shqyrtuara gjatë gjyqit të mëparshëm, mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm, që shkon deri atje sa të japë një gjykim tërësisht në kundërshtim me të mëparshmin. (...)

Kjo është arsyeja pse ligjvënësi lejoi për një rishikim në raste të përkufizuara saktësisht, të cilat janë paraqitur në një dispozitë të posaçme të KPP, sidomos në Nenin 450 (...). Sipas kësaj dispozite, rishikimi mund të kërkohet nga palët vetëm nëse ekziston një prej kërkesave të dhëna shprehimisht aty.”

B. E drejta përkatëse ndërkombëtare

1. Rekomandimi Nr. R (2000) 2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi ri-shqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel kombëtar pas gjykimeve nga Gjykata Europiane e Të Drejtave të Njeriut

33. Më 19 janar 2000, në takimin e 694-t të Zëvendës Ministrave, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin Nr. R (2000) 2 mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel kombëtar pas gjykimeve të Gjykatës Europiane të [Të Drejtave](#) të Njeriut:

“Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës, Duke gjykuar që qëllimi i Këshillit të Europës është të sjellë një bashkim më të afërt mes anëtarëve të tij;

Duke konsideruar Konventën për mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (paskëtaj “Konventa”);

Duke vërejtur që sipas Nenit 46 të Konventës mbi Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (“Konventa”) Palët Kontraktuese kanë pranuar detyrimin për t’iu përmbajtur gjyimit përfundimtar të Gjykatës Europiane të Të Drejtave të Njeriut (“Gjykata”) në çdo

çështje në të cilat ato janë palë dhe që Komiteti i Ministrave do të mbikqyrë ekzekutimin e tij;

Duke mbajtur në mend që në rrethana të caktuara detyrimi i sipër-përmendur mund të nënkuptojë marrjen e masave, të ndryshme nga zgjidhja e drejtë dhënë nga Gjykata në përputhje me Nenin 41 të Konventës dhe/ose masa të përgjithshme, të cilat sigurojnë që pala e dëmtuar vendoset, sa më shumë që të mundet, në të njëjtën situatë që ai apo ajo gëzonte përpara shkeljes së Konventës (*restitutio in integrum*);

Duke vërejtur që është në dorë të autoriteteve kompetente të Shtetit përgjegjës për të vendosur se çfarë masash janë më të përshtatshme për të arritur *restitutio in integrum*, duke marrë parasysh mjetet në dispozicion sipas sistemit ligjor kombëtar;

Duke mbajtur në mend, megjithatë, që praktika e Komitetit të Ministrave në mbikqyrjen e ekzekutimit të gjyqimeve të Gjykatës tregon që në rrethana të jashtëzakonshme rishqyrtimi i një çështjeje apo një rihapje e procedimeve është provuar si më eficienti, në mos i vetmi, mjet për të arritur *restitutio in integrum*;

I. Fton, në dritën e këtyre konsideratave, Palët Kontraktuese të sigurojnë që ekzistojnë në nivelin kombëtar mundësitë adekuate për të arritur, sa më shumë që të jetë e mundur, *restitutio in integrum*;

II. Nxit Palët Kontraktuese, në veçanti, të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore kombëtare me qëllim që të sigurojnë që ekzistojnë mundësi adekuate për rishqyrtim të çështjes, përfshi rihapjen e procedimeve, në rastet kur Gjykata ka gjetur një shkelje të Konventës, sidomos aty ku:

(i) pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja shumë të rënda negative për shkak të përfundimit të vendimit të brendshëm në diskutim, të cilat nuk janë zgjidhur në mënyrë adekuate nga zgjidhja e drejtë dhe nuk mund të ndreqen përveç se me anë të rishqyrtimit apo rihapjes, dhe

(ii) gjykimi i Gjykatës çon në përfundimin që

(a) gjykimi i brendshëm i kundërshtuar është mbi baza në kundërshtim me Konventën, ose

(b) shkelja e gjetur bazohet mbi gabime proceduriale apo mangësi të një shkalle të tillë që hedhin dyshime serioze mbi përfundimin e procedimeve të brendshme që ankimohen.”

34. Memorandumi shpjegues mbi Rekomandimin R (2000) 2 ofron, për aq sa ka lidhje, që:

“ ...

Paragrafi 1 përcakton parimin bazë që qëndron pas rekomandimit që të gjitha viktimat e shkeljeve të Konventës duhet të kenë të drejtë, sa më shumë të jetë e mundur, për një *restitution in integrum* të efektshëm. Palët Kontraktuese duhet, respektivisht, të rishikojnë sistemet e tyre ligjore duke siguruar që mundësitë e nevojshme të ekzistojnë.

...”

2. Detyrimet e Shteteve sipas së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare

35. Neni 35 i Projekt Neneve të Komisionit të Së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Akte të Gabuara Ndërkombëtarisht (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në sesionin e saj të 53-të (2001), dhe riprodhuar në *Regjistrat Zyrtarë të Asamblesë së Përgjithshme*, Sesioni i 56, Suplementi Nr. 10 (A/56/10)) formulohet si më poshtë:

Neni 35: Rivendosja

“Një Shtet përgjegjës për një akt ndërkombëtarisht të gabuar ka detyrimin të kryejë rivendosje, pra, të rivendosë situatën që ekzistonte përpara se të kryhej akti i gabuar, me kusht dhe në atë masë sa rivendosja:

(a) nuk është materialisht e mundur;

(b) nuk ka të bëjë me një barrë jashtë çdo përpjestimi për të mirën që rrjedh nga rivendosja në vend të kompensimit.”

LIGJI

36. Aplikantët u ankuan sipas Nenit 3 të Konventës që ata i ishin nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga policia me qëllim që të detyroheshin të pranonin kundravajtjet e pretenduara.

Neni 3 i Konventës lexon si më poshtë:

““Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës apo trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor apo degradues.”

37. Ata u ankuan gjithashtu për padrejtësinë e procedimeve kundër tyre sipas Nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 1 i Konventës, për aq sa ka lidhje, lexon:

““Në përcaktimin e...çfarëdo akuze penale kundër tij, cilido ka të drejtën e dëgjimit...të drejtë...nga...gjkata...”

I. BASHKIMI I APLIKIMEVE

38. Meqenëse dy aplikimet kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, ankesa dhe procedime nga gjykatat e brendshme, Gjykata vendos që ato duhen bashkuar sipas Rregullit 42 § 1 të Rregullave të Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

A. Ankesa për keqtrajtimin e pretenduar nga oficerët e policisë

39. Qeveria argumentoi se aplikantët nuk i kishin raportuar pretendimet e tyre për keqtrajtim tek autoritetet gjatë hetimit penal. As nuk e kishin shprehur këtë ankesë në apelimet e tyre në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë.

40. Aplikantët këmbëngulën që, në rrethanat e çështjes, thjesht referenca ndaj mos-shterrimit nuk mund ta çlirojë Qeverinë nga detyrimet e saj sipas Konventës apo të paraqitet si një argument i besueshëm përpara kësaj Gjykate.

41. Gjykata rithekson se rregulli i shterrimit të korrigjimeve të brendshme referuar në Nenin 35 të Konventës i detyron ata që kërkojnë ta sjellin çështjen e tyre kundër Shtetit përpara Gjykatës që së pari të përdorin korrigjimet e ofruara nga sistemi ligjor kombëtar (shih *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976, Seritë A nr. 24). Ankesat u duheshin bërë organit të duhur të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet formale të përcaktuara në ligjin kombëtar dhe, më tej, që duhet të ishin përdorur çfarëdo mjetesh procedurale që mund të parandalojnë një shkelje të Konventës (shih *Cardot kundër Francës*, 19 mars 1991, § 34, Seritë A nr. 200).

42. Gjykata vëzhgon që më 24 maj 2002, Gjykata e Rrethit e refuzoi ankesën e aplikantëve për keqtrajtimin e pretenduar si të pakualifikuar në afate. Nga dosja e çështjes del që aplikantët nuk apeluan kundër atij vendimi. As nuk e ngritën këtë ankesë, të paktën në thelb, në apelimet e tyre pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Gjykata arrin në përfundimin që aplikantët nuk arritën të shterronin korrigjimet e brendshme ofruar nga sistemi ligjor kombëtar. Për rrjedhojë, e hedh poshtë ankesën e aplikantëve në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankesa mbi padrejtësinë e procedimeve

1. Mos-shterrimi i korrigjimeve të brendshme

a. Për sa i përket mosarritjes nga aplikanti i dytë për të paraqitur një apelim kushtetues

43. Qeveria argumentoi që aplikanti i dytë nuk kishte apeluar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me ankesën e tij lidhur me padrejtësinë e procedimeve. Ata i kërkuan Gjykatës ta deklaronte të papranueshëm ankesën e tij për shkak të mos-shterrimit të korrigjimeve të brendshme.

44. Aplikanti i dytë argumentoi që nuk kishte asnjë perspektivë të arsyeshme për sukses përpara Gjykatës Kushtetuese duke qenë se apelimi i aplikantit të parë ishte hedhur poshtë.

45. Gjykata vëzhgon se sipas Nenit 35 rekursi normal duhet kryer nga një aplikant për korrigjime që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të mundësuar rivendosje lidhur me shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e korrigjimeve në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë dhe dështimi i tyre çon në mungesën e aksesibilitetit dhe efektshmërisë së nevojshme (shih *Aksoy kundër Turqisë*, 18 dhjetor 1996, § 51, *Raportet të Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-VI*). Një aplikant nuk mund të shihet sikur ka dështuar në shterrimin e korrigjimeve të brendshme nëse ai apo ajo mund të tregojë, duke ofruar raste të çështjeve të brendshme përkatëse apo çfarëdo të dhënash të tjera të përshtatshme, që një korrigjim që ekziston të cilin ai apo ajo nuk e ka përdorur ishte i destinuar të dështonte (shih *Kleyn dhe Tjerët kundër Hollandës [GC]*, nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 156, GjEDNj 2003-VI).

46. Gjykata vëren që aplikanti i parë paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Ai u mbështet mbi të njëjtat argumenta apelimi si ato të paraqitura pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë nga të dy aplikantët. Ankesa e aplikantit të parë u deklarua e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese (shih paragrafët 25–26 më sipër).

47. Duke vlerësuar fatin e apelimit nga aplikanti i parë pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykata beson se çfarëdo apelimi i paraqitur nga aplikanti i dytë pranë Gjykatës Kushtetuese, i cili do të ishte bazuar mbi të njëjtat argumenta apelimi si ato të paraqitura nga aplikanti i parë, do të kishte pasur pak ose praktikisht aspak perspektivë për sukses. Ankesa e aplikantit të dytë, për rrjedhojë, nuk mund të hidhet poshtë me argumentin se kishte dështuar ta paraqiste pranë Gjykatës Kushtetuese brenda kuptimit të Nenit 35 § 1 të Konventës.

48. Për rrjedhojë, Gjykata e hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

b. Në lidhje me mundësinë që aplikantët të kërkojnë një rishikim të gjykimit përfundimtar të tyre

49. Në komentet e tyre të mëtejshme mbi vëzhgimet e aplikantëve, Qeveria paraqiti një letër të ZPP të 16 prillit 2008 që pohonte se “pas verifikimeve të dosjes së hetimit penal [të aplikantëve], u vëzhguan parregullsi proceduriale në kryerjen e disa veprimeve hetimore.” Qeveria pretendoi se aplikantët duhet të kishin kërkuar një rishikim të gjykimit të tyre përfundimtar në përputhje me Nenin 450 të KPP, në dritën e letrës së prokurorit.

50. Gjykata nënvizon që një aplikim për rigjykim apo korrigjim të ngjashëm të jashtëzakonshëm, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të merret parasysh për qëllimet e aplikimit të Nenit 35 § 1 të Konventës (shih edhe, *Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 32567/06, 17 shkurt 2009).

51. Gjykata vëren që rishikimi i një gjykimi përfundimtar të gjykatës në zbatim të Nenit 450 të KPP përbën një masë të jashtëzakonshme (shih paragrafi 32 më sipër). Në këto rrethana, Gjykata beson që aplikantëve nuk u kërkohet ta shterojnë këtë masë.

52. Nëse pretendimi i Qeverisë do të interpretohej me ndikimin se aplikantëve u mungonte statusi i “viktimës”, Gjykata vëzhgon që një vendim apo masë në favor të një aplikanti nuk është në parim i mjaftueshëm për ta privuar atë nga statusi i tij si “viktimë” përveç se kur autoritetet kombëtare pranojnë, shprehimisht ose në thelb, dhe më pas kanë siguruar korrigjim të shkeljes së Konventës (shih, për shembull, *Eckle kundër Gjermanisë*, gjykim i 15 korrikut 1982, Seritë A nr. 51, f. 32, §§ 69 et seq; dhe *Dalban kundër Rumanisë* [GC], nr. 28114/95, § 44, GjEDNj 1999-VI). Në çështjen aktuale, Qeveria nuk paraqiti ndonjë deklaratë për të pranuar ndonjë shkelje të Konventës. As letra e autoriteteve e 16 prillit 2008, për arsyt e përmendura në paragrafet e mëparshme, nuk është e aftë të sigurojë korrigjimin e nevojshëm dhe të kërkuar.

53. Për rrjedhojë, Gjykata e hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

c. Përfundim

54. Gjykata beson që ankimet e aplikantëve sipas Nenit 6 të Konventës ngrenë pyetje të faktit dhe së drejtës që janë mjaftueshëm serioze sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga një shqyrtim i cilësive. Nuk janë përcaktuar arsye të tjera për t’i deklaruar ato të papranueshme. Për rrjedhojë, Gjykata i deklaron të pranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar Nenin 29§ 3 të Konventës (shih paragrafi 4 më sipër), Gjykata do të shqyrtojë menjëherë cilësitë e këtyre ankesave.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6§ 1 TË KONVENTËS

A. Pretendimet e palëve

55. Aplikantët përsëritën pozicionin e tyre se procedura e ndjekur nga gjykatat e brendshme përbënte një mohim të së drejtës së tyre për një gjyq të drejtë. Ata pohuan që refuzimi i gjykatave për të paraqitur fakte, mbi bazën e të cilave ata ishin dënuar (kapuçët), ishte në shkelje të dispozitave të brendshme të vendit. Ata gjithashtu kundërshtuan rregullsinë e procedurës së identifikimit që ishte përdorur nga autoritetet vendase.

56. Qeveria argumentoi që procedura e identifikimit kishte qenë kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj dhe që gjykatat e vendit i kishin vlerësuar si duhet të gjitha të dhënat.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme të zbatueshme në këtë çështje

57. Si rregull i përgjithshëm, është përgjegjësi e gjykatave kombëtare që të vlerësojnë provat përpara tyre si edhe sa lidhen provat që i akuzuari kërkon të shihen si fakte. Megjithatë, Gjykata duhet të vendosë nëse procedimet të konsideruara si e tërë, përfshi mënyrën në të cilën ishin marrë provat, ishin të ndershme siç kërkohej nga Neni 6 § 1 i Konventës (shih *Balliu kundër Shqipërisë*, nr. 74727/01, § 42, 16 qershor 2005).

58. Është një aspekt themelor i së drejtës për një gjyq të drejtë që procedimet penale, përfshi elementë të tillë të procedimeve të tilla që lidhen me procedurën, të jenë kundërshtuese dhe që duhet të ketë një barazi të mjekteve në dispozicion të prokurorisë dhe mbrojtjes (shih *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 27052/95, § 51, 16 shkurt 2000).

59. E drejta për një gjyq kundërshtues nënkupton në parim mundësinë e palëve që një gjyq penal të ketë dijeni dhe të komentojë të gjitha provat e kërkuara si prova apo vëzhgimet e paraqitura me qëllim ndikimin e vendimit të gjykatës (shih *Vermeulen kundër Belgjikës*, 20 shkurt 1996, § 33, *Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve* 1996-I).

60. Parimi i barazisë së mjekteve kërkon “një balancë të drejtë mes palëve,” secilës palë duhet t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij nën kushtet që nuk e vendosin në ndonjë disavantazh thelbësor kundrejt kundërshtarit të tij (shih *Batsanina kundër Rusisë*, nr. 3932/02, § 22, 26 maj 2009).

61. Përveç përmendjes specifike në Nenin 6 § 2 të Konventës, e drejta e një personi në një çështje penale për t’u prezumuar i pafajshëm dhe për t’i kërkuar prokurorisë që të mbartë barrën e vërtetimit të akuzave kundër tij apo saj përbën pjesë të nocionit të përgjithshëm të një dëgjimi të drejtë sipas Neni 6 § 1 (shih *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 41087/98, § 40, GjEDNj 2001-VII).

62. Edhe nëse qëllimi parësor i Neni 6, për sa i përket procedimeve penale, është që të sigurojë një gjyq të drejtë nga një “gjykatë” kompetente për të përcaktuar “ndonjë akuzë penale,” prej tij nuk rrjedh se Neni nuk ka zbatim për procedimet para gjyqit (shih *Imbrioscia kundër Zvicrës*, 24 nëntor 1993, § 36, Seritë A nr. 275). Me qëllim që e drejta për një gjyq të drejtë të mbetet mjaftueshëm “praktike dhe e efektshme,” Neni 6 § 1 kërkon që, si rregull, aksesin ndaj një avokati duhet ofruar nga marrja e parë në pyetje e një të dyshuari nga policia, përveç kur demonstrohet në dritën e rrethanave të veçanta të secilës çështje që ekzistojnë arsye detyruese për ta kufizuar këtë të drejtë (shih *Salduz kundër Turqisë* [GC], nr. 36391/02, §§ 50 dhe 55, 27 nëntor 2008).

2. Aplikimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

63. Në çështjen në fjalë, aplikantët u ankuan që mënyra në të cilën ishte zhvilluar para e identifikimit ishte e padrejtë. Ata pretenduan më tej që gjykatat vendase asnjëherë nuk ranë dakord me kërkesën e tyre që provat materiale (kapuçët) të shqyrtoheshin në seancat publike të çështjeve të tyre. Gjykata, nga ana tjetër, do të shqyrtojë dy bazat e ankesës përpara saj.

64. Gjykata beson që aplikantët u gjetën fajtorë në thelb bazuar mbi forcën e pohimeve të dëshmitarëve okularë të marra gjatë paradës së identifikimit. Ajo vëren se provat e dëshmitarëve okularë që rezultuan nga identifikimi ishte prova kyçe që mbështeste argumentat e prokurorisë kundër aplikantëve.
65. KPP i Shqipërisë rregullon qartë organizimin e një parade identifikimi. Gjykata do të shqyrtojë nëse mënyra në të cilën parada e identifikimit në rastin e aplikantëve u krye në përputhje me kërkesat për të qenë të drejta të Nenit 6.
66. Në radhë të parë, aplikantëve dhe B.L. iu kërkua të qëndronin në radhë duke veshur kapuçë të bardhë dhe blu, të ngjashme në ngjyrë me ato të veshura nga autorët e krimit. Dy personat e tjerë në radhë kishin veshur kapuçë të zinj, në kontrast të fortë me kapuçët e bardhë dhe blu që kishin aplikantët dhe B.L. të cilët u akuzuan për kryerjen e krimit. Ndryshimi i pozicionit të personave në radhë nuk rezultoi në ndonjë rezultat të ndryshëm për aplikantët, sepse iu kërkua gjithë kohës të vishnin kapuçët (shih paragrafin 13 më sipër) me të njëjtën ngjyrë (bardhë e blu). Gjykata gjen se parada e identifikimit ishte e barabartë me një ftesë për dëshmitarët për të drejtuar gishtin e fajta drejt të dy aplikantëve dhe B.L. si autorët e krimit.
67. Për më tepër, parada e identifikimit u krye në mungesë të avokatëve të aplikantëve. nga dosja e çështjes nuk del se aplikantët kishin hequr dorë me vullnetin e tyre të lirë, shprehimisht apo tërthorazi, të drejtën për ndihmë ligjore në kohën e paradës së identifikimit (shiko, në kontrast, *Kwiatkowska kundër Italisë* (vendim), nr. 52868/99, 30 nëntor 2000).
68. Gjykata vëren në këtë lidhje se edhe pse Gjykata e Rrethit pranoi se kishte pasur parregullsi në fazën e hetimit, duke dënuar aplikantët ajo u mbështet mbi identifikimin pozitiv të aplikantëve kryer nga dëshmitarët okularë në paradën e identifikimit (shih *Salduz*, cituar më sipër, § 58).
69. Nuk pati mbikqyrje të pavarur të drejtësisë së procedurës apo ndonjë mundësi për të protestuar kundër parregullsive flagrante. Gjykata gjen se injorimi i qartë i së drejtës për mbrojtje në këtë fazë paragjykoj në mënyrë të pakthyeshme drejtësinë e gjyqit penal që pasoi.
70. Së fundi, Gjykata vëren që nuk është shpjeguar se pse kërkesat e aplikantëve që kapuçët e përdorur gjatë paradës së identifikimit të nxirreshin përpara gjykatës u refuzuan. Ndërkohë që është e vërtetë se e drejta për nxjerrjen e provave përkatëse nuk është absolute, Gjykata duhet të kontrollojë procedurën e vendim-marrjes për t'u siguruar nëse, për aq sa ishte e mundur, procedura përputhej me kërkesat për të siguruar procedime kundërshtuese, barazi të mjeteve dhe përfshinte mbrojtje adekuate për të mbrojtur interesat e të akuzuarit (shih *Jasper*, cituar më sipër §§ 52-53).
71. Gjykata beson që në rrethanat e çështjes së aplikantëve, drejtësia kërkonte që atyre t'u jepej mundësia të argumentonin që kapuçët që u ishte kërkuar të vishnin në paradën e identifikimit, çka përbënte provë vendimtare për dënimin e aplikantëve, ishin tërësisht të

ndryshme nga ato që ishin veshur nga grabitësit. Megjithatë, atyre iu mohua mundësia në gjyq që të korrigjonin parregullsitë e ndodhura në paradën e identifikimit. Në këtë lidhje, Qeveria nuk ngriti ndonjë bazë interesi publik për mosparaqitjen e provave të tilla, dhe nga procedimet në vend nuk dukej se kishte të tilla baza.

72. Në përfundim, duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin që procedimet në fjalë nuk plotësonin kërkesat për një gjyq të drejtë. Për rrjedhojë, është kryer një shkelje e Nenit 6 § 1 në çështjen aktuale.

IV. APLIKIMET E NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

73. Neni 46 siguron:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të zbatojnë gjykimin përfundimtar të Gjykatës në çfarëdo çështje në të cilën janë palë.

2. Gjykimi përfundimtar i Gjykatës do t’i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili do të mbikqyrë ekzekutimin e tij.”

74. Në çështjen në fjalë, Gjykata gjeti se e drejta e aplikantëve për një gjyq të drejtë ishte shkelur seriozisht nga autoritetet vendase. Gjykata beson që kur aplikanti është dënuar në shkelje të të drejtave të tij siç garantohen nga Neni 6 i Konventës, ai duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin do të kishte qenë nëse kërkesat e asaj dispozite nuk do të ishin injoruar, dhe që forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte gjyqi *de novo* ose rihapja e procedimeve, nëse do të kërkohej (shih *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009; *Salduz*, cituar më sipër, § 72; *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, § 82, 29 korrik 2008; *Öcalan kundër Turqisë* [GC], nr. 46221/99, § 210 *in fine*, GjEDNj 2005-IV).

75. Për këtë arsye, Gjykata gjykon se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse do të kërkohej nga aplikanti, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme të korrigjimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, të cilat në Rekomandimin Nr. R (2000) 2 u bënë thirrje Shteteve Palë të Konventës që të prezantonin mekanizma për rishqyrtim të çështjes dhe rihapje të procedimeve në nivel kombëtar, duke gjetur që masa të tilla përfaqësonin “mjetin më të efektshëm, në mos të vetmin, për të arritur rikthim *in integrum*” (shih paragrafin 33 më sipër). Kjo pasqyron gjithashtu edhe parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një Shtet përgjegjës për një akt të gabuar ka detyrimin të kryejë rikthimin, i cili përbëhet nga kthimi në situatën që ekzistonte përpara se të kryhej akti i gabuar (Neni 35 i Projekt Neneve të Komisionit të Së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Akte Ndërkombëtarisht të Gabuara – shih paragrafi 35 më sipër, dhe, *mutatis mutandis*, *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës* (nr. 2) [GC], nr. 32772/02, §§ 85-86, GjEDNj 2009-...).

76. Gjykata vëren që sistemi ligjor penal i Shtetit përgjegjës nuk ofron mundësinë për rishqyrtim të çështjeve, përfshi rihapjen e procedimeve në vend, në rastet kur kjo Gjykatë gjen një shkelje serioze të së drejtës së një aplikanti për një gjyq të drejtë. Nuk varet nga Gjykata që të tregojë se si duhet siguruar një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti përgjegjës mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, që të zgjedhë mjetet me anë të së cilave do të ushtrojë detyrimin e tij për ta vendosur aplikantin, sa më shumë që mundet, në pozicionin që do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin injoruar (shih *Piersack kundër Belgjikës* (Neni 50), 26 tetor 1984, § 12, Seritë A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë të përputhshme me përfundimet e përcaktuara në gjykimin e Gjykatës dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih (see *Lyons dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 15227/03, GjEDNj 2003-IX).

77. Megjithëkëtë, Gjykata beson se varet nga Shteti përgjegjës që të largojë ndonjë pengesë në sistemin e vet kombëtar ligjor që mund ta parandalojë situatën e aplikantit që të korrigjohet si duhet (shih, mes autoriteteve të tjera, *Karanović kundër Bosnjes dhe Hercegovinës*, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007) apo të prezantojë një korrigjim të ri që do t'iu jepte mundësi aplikantëve që situata e tyre të riparohej. Për më tepër, Shtetet Kontraktuese kanë për detyrim të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të plotësojnë kërkesat e Konventës. Ky parim ka vlerë edhe për rihapjen e procedimeve dhe rishqyrtimin e çështjes së aplikantëve (shih, *mutatis mutandis*, *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT)* (nr. 2), cituar më sipër, § 97.)

B. Neni 41 i Konventës

78. Neni 41 i Konventës siguron:

“Nëse Gjykata gjen se ka pasur një shkelje të Konventës apo Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese përkatëse lejon vetëm kryerjen e kompensimeve së pjesshme, atëhere Gjykata, nëse është nevojshme, duhet të përballojë zgjidhjen e drejtë për palën e dëmtuar.”

79. Aplikantët kërkuan pagesën prej 12,000 euro (EUR) secili kundrejt demit financiar që kishin vuajtur. Kjo ishte bazuar mbi një llogaritje të të ardhurave të humbura në përputhje me pagën minimale në Shqipëri. Ata kërkuan 20,000 Euro secili kundrejt demit jo-financiar.

80. Qeveria i kërkoi Gjykatës të refuzonte pretendimin e aplikantëve për zgjidhje të drejtë.

A. Dëmi

81. Lidhur me dëmin financiar që pretendohet të jetë shkaktuar, Gjykata përsërit se duhet të ketë një lidhje të qartë shkaku midis dëmit të kërkuar nga aplikanti dhe shkeljes së Konventës (shih, mes të tjerash, *Dybeku kundër Albania*, nr. 41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

82. Gjykata, duke pasur parasysh gjetjet e saj lidhur me ankesat e aplikantëve sipas Nenit 6 § 1, shqyrton se nuk është vendosur ndonjë lidhje shkakore midis demit të pretenduar dhe shkeljeve që ka gjetur. Gjykata nuk mund të spekulojë se çfarë mund të kishin qenë përfundimet e procedimeve penale kundër aplikantit nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja e Konventës (shih *Polufakin dhe Chernyshev kundër Rusisë*, nr. 30997/02, § 216, 25 shtator 2008). Për rrjedhojë, Gjykata e gjen të papërshtatshme që t'u akordojë aplikantëve kompensim për dëmin e pretenduar financiar.

83. Në lidhje me pretendimin për dëm jofinanciar, duke vendosur mbi një bazë të drejtë, Gjykata i akordon secilit aplikant 4,800 euro, plus çfarëdo takse që mund të jetë e aplikueshme mbi këto shuma.

B. Kostot dhe shpenzimet

84. Aplikantët nuk paraqitën një pretendim për kostot dhe shpenzimet. Përkatësisht, Gjykata gjykon se nuk ka kërkesë për t'u akorduar atyre ndonjë shumë mbi këtë bazë.

C. Interesi bazë

85. Gjykata e gjykon të përshtatshme që interesi bazë duhet të bazohet mbi kursin marxhinal të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, ndaj të cilit duhet të shtohen tre pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *Vendos* t'i bashkojë aplikimet;
2. *Deklaron* ankesën e aplikantëve sipas Nenit 3 të Konventës të papranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme;
3. *Gjykon se* ka pasur një shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës;
4. *Gjykon*
 - (a) që Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë secilit aplikant, brenda tre muajsh nga data në të cilën gjykimi merr formë të prerë në përputhje me Nenin 44 § 2 të Konventës, 4,800 Euro (katër mijë e tetëqind euro) për dëm jofinanciar, që duhet të konvertohet në monedhën kombëtare të Shtetit përgjegjës me kursin e aplikueshëm në datën e vendosjes, plus ndonjë taksë që mund të jetë e aplikueshme;
 - (b) që nga skadimi i tre muajve të sipër-përmendur deri në zgjidhje, duhet të paguhet interes i thjeshtë për shumën e mësipërme baras me kursin marxhinal të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhave bazë plus tre pikësh përqindje;
5. *Rrëzon* pjesën e mbetur të pretendimit të aplikantëve për zgjidhje të drejtë;

Kryer në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 20 prill 2010, në zbatim të Rregullit 77 §§
2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Fatoş Aracı Nicolas Bratza
Zëvendës Regjistrues President

GJYKIM LASKA DHE LIKA kundë r SHQIPËRISË

GJYKIM LASKA DHE LIKA kundë r SHQIPËRISË